




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



**Emri i Biznesit:** Sadik Bytyqi B.I.  
**Emri Tregtar:** N.P.T. Galaktika  
**Numri Unik Identifikues:** 810606220  
**Numri i biznesit:** 70111954  
**Pronar:** Sadik Bytyqi  
**Operatori i Shpërndarjes:** Galaktika  
**Adresa:** Korishë, Prizren



**VENDIM**

për ripërtëritjen e licencës së KPM-së për operatorin e shpërndarjes Galaktika, me seli në Korishë, Komuna e Prizrenit

**Faktet**

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Galaktika është operatorë i shpërndarjes, i cili ishte licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuale përmes platformës Kabllore, me seli në Korishë, Komuna e Prizrenit. KPM, me datën 9 gusht 2013, ka marr vendim për dhënien e licencës për operatorë të shpërndarjes Galaktika.
3. Me datën 9 gusht 2023, ka skaduar afati i licencës së OSH Galaktika, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidatit i ofrohet e drejta të kërkojë ripërtëritjen e licencës në afat brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Me datën 18 prill 2023, KPM përmes e-mailit, ju ka dërguar shkresë të gjithë operatorëve të shpërndarjes të cilëve afati i licencës ju skadon në vitin 2023, në mesin e tyre edhe operatorit Galaktika, përmes së cilës shkresë i ka njoftuar lidhur me skadimin e afatit të licencës dhe mundësin e ripërtëritjes së saj, në pajtim me Nenin 25 të Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur të Mediave.
5. Më datën 11 maj 2023, operatori i shpërndarjes Galaktika ka parashtruar kërkesën në zyrën e KPM-së, me anë të së cilës ka shprehur interesimin për ripërtëritje të Licencës së KPM-së.

6. Për shkak të pamundësisë së vendimmarrjes së Komisionit të Pavarur të Mediave për arsye të mungesës së kuorumit, nga data 15 tetor 2022 deri më datën 6 qershor 2023, kërkesa e OSH Galaktika, nuk ka arritur të shqyrtohet me kohë.


### Arsyvetimi

7. Neni 25 i Ligjit për KPM-në përcakton: *“Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritjet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audio-vizuel privat për sa u përket kushteve dhe kriterëve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Komisioni brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës”.*
8. Me anë të shkresës së datës 18 prill 2023, lidhur me njoftimin për skadimin e afatit të licencës, KPM ka njoftuar operatorin e shpërndarjes Galaktika lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për ripërtëritjen e licencës.
9. Komisioni konstaton se operatori i shpërndarjes Galaktika, përmes kërkesës me shkrim, ka shprehur interesim për vazhdimin e veprimtarisë së shpërndarjes së ofrueseve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale.
10. Komisioni konsideron se nuk janë evidentuar shkelja të tilla të dispozitave materiale të Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, nga operatorit të shpërndarjes Galaktika të cilat shkelje do të pamundësonin ripërtëritje e licencës.
11. Komisioni konstaton se Galaktika ka shlyer të gjitha obligimet financiare ndaj KPM - së, përfshirë këtu edhe pagesën e tarifës administrative për ripërtëritje të licencës e paraparë me Rregulloren KPM-2017/06.
12. Komisioni konstaton se sipas verifikimit në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK), përmes të dhënave mbi bizneset që mund të shihen në faqen e internetit të kësaj agjencie, nuk ka ndryshim të pronësisë së OSH Galaktika.
13. Komisioni vlerëson se kërkesa për ripërtëritjen e licencës së operatorit të shpërndarjes Galaktika është dorëzuar në pajtim me dispozitat ligjore të parapara me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë kërkesa i plotëson kushtet për miratim dhe se ripërtëritja e licencës është në interesin e publikut në zonën në të cilën operon ky operator i shpërndarjes.

### Vendim

14. Komisioni në takimin e datës 13 shtator 2023, merr vendim për miratimin e kërkesës për ripërtëritjen e licencës së operatorit të shpërndarjes Galaktika, për të ushtruar veprimtarinë e shpërndarjes së ofrueseve të shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuale në Republikën e Kosovës.

15. Licenca e KPM-së për operatorin e shpërndarjes Galaktika do të jetë e vlefshme në afat prej 10 (dhjetë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 9 gusht 2023.
16. Të gjitha parametrat e Licencës së KPM-së, shtrirja e rrjetit të operatorit të shpërndarjes Galaktika, si dhe lista e kanaleve sipas katalogut që është pjesë përbërëse e Licencës së KPM-së, mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.
17. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.

  
Jeton Mehmeti  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur i Mediave



13.09.2023  
datë